

Hapet thirrja për mobilitet (bursë) studentësh të UPT-së, në Universitetin Hosei, në Japoni

Universiteti Hosei, Japoni, pranon 1 student të Universitetit Politeknik të Tiranës, me arritje të shkëlqyera akademike, me njohuri të gjuhës japoneze, ose angleze dhe me dëshirë për të bërë kërkim shkencor në Japoni.

Periudha e studimit: Shtator 2022- Mars 2024.

Kriteret e pranimit:

1. Statusi: Student për kërkim shkencor (jo në kërkim të gradës Bachelor).
2. Niveli i pranimit:
 - Program Master apo doktoral në shkollën e të diplomuarve në Universitetin Hosei.
 - Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:
 - a) Nivel N2, ose më të lartë në testin e gjuhës japoneze (Japanese Language Proficiency Test), ose
 - b) Nivel të gjuhës angleze B2, ose më shumë, sipas Kuadrit European Referencial të Gjuhëve (CEFR).

Për kandidatët e programit të studimit në anglisht këshillohet që të studiohet japonishtja në mënyrë personale për komunikim të përditshëm para mbërritjes në Japoni. Universiteti Hosei nuk ofron kurse të gjuhës japoneze.

Fusha e dëshiruar e edukimit dhe kërkimit duhet të jetë e praktikueshme në fushat e studimit apo të kërkimit në Universitetin Hosei.

Per informacion në lidhje me stafin e mësimdhënies në Universitetin Hosei, referojuni këtyre faqeve web:

- Hosei University Graduate Schools <https://www.hosei.ac.jp/gs/>
- Hosei University Academic Researcher Database <http://kenkyu-web.i.hosei.ac.jp/scripts/websearch/>

3. Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët (master, doktoraturë):

- CV;
- Kopje e pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash e studimeve deri në momentin e aplikimit;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit: **21 janar 2022**

Nga universiteti Hosei nuk pranohen kërkesa për informacion, apo aplikime personale. Pranohen vetëm komunikimet institucionale, ndërmjet dy universiteteve.